

BACHELOR NË “INXHINIERI NDËRTIMI”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Ndërtimi” synon të përgatisë studentët për zgjidhjen profesionale të detyrave inxhinierike, duke i pajisur me njohuri themelore dhe aftësi praktike në projektimin dhe zbatimin e strukturave, objekteve dhe veprave inxhinierike. Studentët do të zhvillojnë kompetenca për përballimin e sfidave teknike dhe shkencore në projekte të ndryshme ndërtimi, në bashkëpunimin me specialistë dhe kolegë të fushave të tjera ndërdisiplinore.

REZULTATET E TË NXËNIT

Në përfundim të programit Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi," studenti do të jenë i aftë të:

- Identifikojë dhe analizojë probleme teknike që lidhen me ndërtimin e strukturave, objekteve dhe veprave inxhinierike, si dhe të propozojnë zgjidhje efektive për zbatimin e tyre.
- Hartojë dhe mbikëqyrë zbatimin e projekteve ndërtimore duke respektuar standardet teknike dhe rregulloret ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Përgatisë dhe zhvillojë "Planin kalendarik" të punimeve dhe të menaxhojë dokumentacionin e punimeve, duke siguruar që projekti të zhvillohet sipas planifikimit dhe në përputhje me kërkesat e kantierit.
- Aplikojë metoda të avancuara të llogaritjes dhe projektimit strukturor për të siguruar qëndrueshmërinë, rezistencën dhe sigurinë e strukturave ndërtimore.
- Zhvillojë aftësi për të vlerësuar ndikimin mjedisor të projekteve, për të implementuar zgjidhje për uljen e ndikimeve negative të proceseve të ndërtimit në mjedis, duke përdorur praktika të qëndrueshme dhe teknologji të reja.
- Përdorë software dhe aplikacione të specializuara inxhinierike për modelim dhe simulim të strukturave, si dhe për menaxhimin e projekteve dhe burimeve të tyre.
- Koordinojë dhe bashkëpunojë me aktorët e ndryshëm të procesit të ndërtimit, duke përfshirë projektuesit, nënkontraktorët, konsulentët dhe palët e interesuara, për të siguruar përmbushjen e qëllimeve të projektit.
- Vlerësojë dhe përzgjedhë materialet më të përshtatshme të ndërtimit për secilin projekt, bazuar në performancën, koston dhe qëndrueshmërinë e tyre.
- Mbikëqyrë zbatimin e teknologjive moderne të ndërtimit duke përfshirë qasjet digjitale dhe praktikatat inxhinierike të qëndrueshme për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e projekteve.
- Përdorë aftësi menaxheriale dhe drejtuese për të organizuar dhe mbikëqyrur ekipet e ndërtimit, duke koordinuar në mënyrë efektive burimet dhe proceset në kantier.
- Zbatojë rregullat dhe standardet e sigurisë në kantier, për të siguruar mbrojtjen e punonjësve dhe për të minimizuar rreziqet gjatë proceseve të ndërtimit.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi mund të punësohen në fushat e mëposhtme:

- Inxhinierë të projekteve të ndërtimit në kompani ndërtimi, zhvillues të pasurive të patundshme dhe agjenci ndërtimi.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- Specialistë në mbikëqyrjen e ndërtimit në firma ndërtimi, kompani ose institucione që ofrojnë konsulencë për ndërtim dhe agjenci mbikëqyrjeje.
- Inxhinierë të materialeve ndërtimore në kompani prodhuese të materialeve ndërtimore, kompani të teknikave të ndërtimit dhe laboratorë testimi.
- Inxhinierë të sigurisë dhe shëndetit në punë në kompani/institucione që ofrojnë konsulencë për sigurinë në punë dhe kompani ndërtimi.
- Inspektor i ndërtimit për mbikëqyrjen dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së projekteve të ndërtimit, duke siguruar që ato përmbushin standardet e përcaktuara ligjore dhe teknike.
- Specialistë ndihmës për projektimin struktural në firma inxhinierike, studio projektimi dhe kompani konsultimi.
- Inxhinierë të rrugëve dhe infrastrukturës në kompani ndërtimi, autoritetet lokale të transportit dhe agjencitë qeveritare.
- Specialistë të ndërtimit të objekteve civile në kompani ndërtimi, firma rikonstruksioni dhe institucione të administratës publike.



BACHELOR "INXHINIERI NDËRTIMI" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

I. PERGATITJE METODOLOGJIKE DHE KULTURE TE PERGJITHSHME

A - LËNDË BAZË/ 15-20%/32 ECTS

1	I	2	Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi	8
2	I	1	Algjebër dhe Gjeometri	6
3	I	1	Analizë matematike 1	6
4	I	2	Analizë matematike 2	6
5	II	1	Hyrje në ekonomi	6

32

II. PERGATITJE PER DISIPLINEN SHKENCORE

B - LËNDË KARAKTERIZUESE TE PROGRAMIT 50-55%/99 ECTS

1	I	1	Kimi e përgjithshme dhe inorganike	6
2	I	1	Fizikë I	5
3	I	2	Fizikë II	6
4	I	2	Hyrje në probabilitet	6
5	II	2	Mekanikë racionale	6
6	I	1	Shkenca dhe teknologjia e materialeve të ndertimit	6
7	II	2	Fizikë teknike dhe ambientale	6
8	II	2	Topografi	5
9	II	2	Shkenca e Konstruksioneve 1	5
10	III	1	Shkenca e Konstruksioneve 2	5
11	III	1	Gjeologjia	6
12	III	1	Konstruksion Beton Arme	8
13	III	1	Konstruksione Ruge, Hekurudha dhe Aeroporte	6
14	III	1	Konstruksion çeliku dhe druri	6
15	III	2	Kantieri, teknologjia dhe siguria në ndërtim	10
16	III	2	Gjeoteknikë (dherat)	6

98

III - NENDISIPLINA, ORIENTIME DHE GRUP- LENDE ME ZGJEDHJE

C - LËNDË NDËRDISIPLINORE / INTEGRUESE /12-15%/22 ECTS

1	II	1	Algoritmikë dhe hyrje në programim	6
2	II	2	Bazat e Projektimit Arkitektonik	6
3	I	2	Gjeometri Deskriptive 1	5
4	II	1	Cad dhe Grafikë 1	6
5	II	2	Impiante ndërtësash, Hidraulikë	5
6	II/III		Honors course	6

22

D - LËNDË PLOTËSUESE 10-15%/21 ECTS

1	II	1	Anglisht B1	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	II	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	III	2	Praktikë profesionale	6

21

E - DETYRIME PËRMBYLLËSE/3-5% /7 ECTS

1	III	2	Punimi i Diplomës / Provim i Përgjithshëm Përfundimtar	7
---	-----	---	--	---

Totali 180